




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gjiçane Belediyesi

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, nenit 17, pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/ datë 04 Qershor 2008); nenin 25 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (GZ e R.Kosovës nr.10/03 Prill 2019); nenit 29, paragrafi 3, paragrafi 4 dhe paragrafi 1.5 nenit 31 të Rregullores QRK nr.09/2020 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Nenit 37, pika 1.2 , 1.3 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Gjiçanit (01.nr.016-126211 të datës 06.11.2014) me qëllim të sigurimit të tokës për zbatimin e kompetencave të plota dhe ekskluzive të Komunës të parapara me nenin 17 LVL-së (Ligji nr.03/L-040), për planifikimin urban dhe rural; shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, trajtimin e rrugëve lokale, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.03.2026 miraton këtë :

V E N D I M

Për lejin e këmbimit të pronave të paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Kadrush Sylës nga Gjiçani, Lagja "Dheu i Bardh" - Gjiçane.

I.

Kuvendi i Komunës e APROVON propozimin e Kryetarit të Komunës 02.nr.551 të datës 17.04.2025 për lejin e këmbimit të pronave të paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Kadrush Sylës nga Gjiçani.

II.

Sipas propozimit të cekur në pikën I, këmbimi përfshin, njësitë kadastrale ose pjesët e njësive kadastrale:

- 2.1 Pjesën prej 32 m² të njësisë kadastrale : P-70403013-02051-1, lloji i njësisë: parcelë; pronë shoqërore, zona urbane, vendi i quajtur "Dheu i Bardh", sipërfaqja 541 m², rrugë e pakategorizuar, pronar : Komuna e Gjiçanit;
- 2.2 Pjesën prej 3m² të njësisë kadastrale : P-70403013-02053-3, lloji i njësisë: parcelë; pronë shoqërore, zona urbane, vendi i quajtur "Dheu i Bardh", sipërfaqja 3668 m², rrugë e pakategorizuar, pronar : Komuna e Gjiçanit;
- 2.3 Pjesën prej 35m² të njësisë kadastrale : P-70403013-01904-1, lloji i njësisë: parcelë; pronë private, zona urbane, vendi i quajtur "Dheu i Bardh", sipërfaqja 436 m², tokë ndërtimore , pronar : Kadrush Sylë (Nazmi).

III.

Pjesët e sipërfaqeve për këmbim gjinden në kufijt kadastral njëra me tjetrën, në Zonën Kadastrale në Gjilan, Lagja "Dheu i Bardh", kurse këmbimi i tyre është në funksion të përmbushjes së interesit publik pasi që një pjesë e rrugës së lagjës është e shtruar në pronën private të pronarit Kadrush Sylja.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Vlerësimit financiar të pronave të cilat janë objekt i këmbimit, i datës 29.05.2025 i hartuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 ditë publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr.016-22109/26

Gjilan, më 26.03.2026



Kryesuesjs e KK Gjilan
[Signature]
Krenare Latifi Kqiku